



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Nr. 65/ Prot.

127

Tiranë, më 30 .05. 2023

**Drejtuar : MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BUXHETIT**

TIRANË

Lënda: Raporti i Monitorimit të Buxhetit për periudhën Janar-Prill të vitit 2023.

Në mbështetje të Ligjit nr.84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, në vijim të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ”, lutemi gjeni bashkëlidhur Raportin e Monitorimit të Buxhetit të 4-mujorit të parë të vitit 2023 të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Raporti i monitorimit të katër mujorit Janar–Prill 2023 krahas analizës së shpenzimeve buxhetore në nivel programi përmban dhe një analizë të objektivave institucionale referuar performancës buxhetore të orientuar drejt rezultateve.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,



PËRMBAJTJA	Faqe
Hyrje	2
Raport i monitorimit të buxhetit të KLSH-së për Janar-Prill 2023	2
Analiza e realizimit të buxhetit të KLSH-së për vitin 2023	3-4
Analiza e objektivave institucionale të KLSH-së, referuar buxhetit të orientuar në rezultate.	5
Mbi realizimin e objektivave të menaxhimit institucional	5-7
Aneksi Nr. 1 Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve.	8
Aneksi Nr. 2 Raporti i shpenzimeve të Programit sipas artikujve buxhetorë.	9
Aneksi Nr. 3 Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës /produkteve të programit.	10
Aneksi Nr. 4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit.	11
Aneksi Nr. 5 Projektet e investimeve me financim të brendshëm dhe të huaj.	12

HYRJE

KLSH ka kryer monitorimin e buxhetit të periudhës Janar-Prill 2023, nëpërmjet vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore dhe krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar. Nëpërmjet këtij raporti monitorimi evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të KLSH-së të detajuar në nivel kategori shpenzimi buxhetor kundrejt treguesve të planifikuar duke mundësuar në këtë mënyrë riorientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit. Në vijimësi dhe strukturat respektive të KLSH-së kanë kryer monitorimin e treguesve buxhetore më qëllim ndjekjen në vijimësi të objektivave të synuar dhe të përcaktuar në Deklaratën e politikës së programit të KLSH-së të përfshirë në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2018-2022.

Në mbështetje të Ligjit nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, dhe në vijim të udhëzimit të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.07.2018, “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQK”, për periudhën Janar-Prill 2023, performanca e realizimit të buxhetit, paraqitet si më poshtë:

PROGRAMI 01120 “VEPRIMTARI AUDITUESE E KLSH-së”

Buxheti i akorduar për programin “Veprimtari audituese e KLSH-së”, ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës të hartuar gjatë procesit të PBA 2023-2025 dhe është në funksion të kësaj Deklarate. Politika buxhetore e KLSH-së është fokusuar në përmbushjen me cilësi të lartë dhe në kohë të detyrimeve ligjore, të objektivave, si dhe prioritetëve të institucionit të parashikuar në Planin e Zhvillimit Strategjik 2023-2027, duke konsideruar kërkesat e organizmave ndërkombëtarë të auditimit dhe të BE-së të përcaktuara në MSA-në e Shqipëri-BE dhe të monitoruara në kuadrin e Integrimit Evropian.

“RAPORTI I SHPENZIMEVE FAKTIKE TË PROGRAMIT SIPAS ARTIKUJVE PËR PERIUDHËN JANAR-PRILL 2023”

Në zbatim të Ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, është bërë miratimi i çeljes dhe rishikimit të fondeve buxhetore për vitin 2023, për institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Fondet e alokuara për funksionimin e aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, sipas zërave për vitin 2023, paraqiten si më poshtë:

KOD	Artikulli	Pershkrimi	Fakti 2022	Plani Vjetor 2023	Plani Janar-Prill	Në mijë lekë	
						Shpenzime Janar Prill	Difer.
1024001	600	Paga	290,957	351,300		104,032	
1024001	601	Sigurime Shoqërore	47,126	46,800		16,902	
	600+601	Shpenzime per paga	338,083	398,100	132,000	120,934	11,066
1024001	602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	72,158	87,850		18,253	
1024001	605	Transferta Korente të Huaja		150		116	
1024001	606	Trans per Individ		1,600		0	
	602,605,606	Shpenzime Korente	72,158	89,600	30,800	18,369	12,431
1024001	231	Kapitale të Trupëzuara	13,032	13,400		25	
1024001	231	Kapitale të Trupëzuara		1,600		0	
1024001	230	Kapitale të Pa Trupëzuara	4,291	5,000		1,090	
	231	Financim i Brendshem	17,323	20,000	20,000	1,115	18,885
	230	Financim i Huaj		3,000	3,000	5,400	
		Totali	427,564	509,100	185,800	145,818	39,982

ANALIZA E REALIZIMIT TË BUXHETIT TË KLSH-SË PËR PERIUDHËN JANAR-PRILL 2023

Bazuar ne Ligjit 84/2022, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2023” KLSH për vitin 2023 u miratua fondi në total në vlerën 509,100 mijë lekë, nga të cilat 486,100 mijë lekë për shpenzime korente dhe 23,000 mijë lekë për Shpenzime Kapitale nga të cilat 20,000 mijë lekë Shpenzime Kapitale me Financim të Brendshëm dhe 3,000 mijë lekë me Financim të Huaj.

1- Pagat, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore. Llogaria 600-601.

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2023 në Ligjin nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, për zërin “Paga dhe Sigurime ” është në vlerën për 398,100 mijë lekë dhe numri i miratuar i punonjësve është 243 punonjës.

Për periudhën progresive Janar-Prill buxheti i planifikuar në masën për 132,000 mijë lekë është realizuar në vlerën për 120,934 mijë lekë ose realizuar në masën 92%.

Shuma e shpenzuar në zërin Shpenzime Personeli, përfshin pagat e punonjësve të KLSH-së dhe të ekspertëve të jashtëm të përkohshëm të kontaktuar dhe paguar konform shkresave dhe kontratave të nënshkuara me ta.

2- Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera. Llogaria 602.

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2023 në Ligjin nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, për zërin shpenzime operative, është në vlerën për 88,000 mijë lekë, ose 17 % e planit buxhetor të vitit 2023.

Plani për periudhën Janar-Prill në vlerën për 30,650 mijë lekë është realizuar në vlerën për 18,253 mijë lekë. ose janë realizuar në masën 60%.

Me këtë zë shpenzimesh janë përballuar mbulimi i nevojave administrative të shpenzimeve si shpenzime për shërbimin e sigurisë, drita, ujë, telefon etj. Një pjesë të konsiderueshme në shpenzimet operative e zënë shpenzimet për udhëtim e dieta brenda vendit në vlerën për 11,511 mijë lekë dhe që përfaqësojnë 63% të shpenzimeve faktikë korente.

Aktualisht, për vitin 2023, KLSH , ka realizuar disa procedura prokurimi në lidhje me:

-Rinovim suporti të licenca të Fireëall dhe E-Mail Security. Prokurimi i rinovimit të licencave të sipërpërmendura i ka shërbyer KLSH-së për funksionimin optimal të pajisjeve të teknologjisë së informacionit, rritjen e sigurisë së rrjetit si dhe lehtësimin e punës së përdoruesve të infrastrukturës teknologjike të KLSH-së.

-Blerje karburanti për automjetet, shërbim interneti për institucionin, mirëmbajtje ashensori, sistem alarmi, shërbim automjetesh.

3- Transferta korrente dhe të huaja. Llogaria 605.

Për periudhën raportuese 2023, janë shlyer detyrimet për kuota anëtarësimi për organizatat INTOSAI dhe EUROSAI, në shumën 126 mijë lekë nga 150 mijë lekë të planifikuara.

4- Transferta për buxhetet familjare. Llogaria 606.

Gjatë periudhës ushtrimore 2023, është dhënë Fond i Veçantë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në vlerën 1,600 mijë lekë, për daljen e punonjësve në pension, rast fatkeqësie dhe sëmundjeje vlerë e cila përgjatë kësaj periudhe nuk është shpenzuar.

5- Shpenzime për investime kapitale. Llogaria 230-231.

Bazuar në Ligjin nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, plani i buxhetit me destinacion Investimet Kapitale është në shumën 23,000 mijë lekë, nga të cilat 20,000 mijë lekë

investime me Financim të Brendshëm dhe 3,000 mijë lekë për investime kapitale me Financim të Huaj.

Kodi i projektit	Pershkrimi	Në mijë lekë
		Plani Vjetor
M240009	Blerje paisje kompjuterike	13,400
M240010	Blerje paisje zyre	1,600
19AA402	Kosto Lokale	5,000
		20,000

Për vitin 2023, plani i buxhetit në zërin “Kosto lokale”, është në vlerën për 5,000 lekë dhe që i përket shpenzimeve për projektin e investimit “Forcimi i rolit të Auditimit të Jashtëm në mbikëqyrjen e partneritetit publik-privat në Shqipëri”. Për periudhën Janar-Prill, ky zë është realizuar në masën për 1,090 mijë lekë.

Për vitin 2023, KLSH ka prokuruar fondet në vlerën 666 mijë lekë për blerje paisje zyre, procedurë e cila ka përfunduar në muajin maj.

B-Financim i Huaj

Bazuar në Ligjin nr.84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, plani i buxhetit me destinacion Investimet Kapitale me Financim të Huaj në artikullin 230 është miratuar në vlerën **3,000 mijë lekë** dhe është parashikuar për zbatimin e projektit, “**Forcimi i rolit të Auditimit të Jashtëm në mbikëqyrjen e partneritetit publik-privat në Shqipëri**”. Për periudhën Janar – Prill, ky projekt është realizuar në vlerën për **5,400 mijë lekë**.

Bashkëpunimi mes KLSH-së dhe Sekretariatit të Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO) i Konfederatës zvicerane do të mbështesë ngritjen e kapaciteteve profesionale të audituesve të KLSH-së, por do të jetë njëkohësisht edhe promotori i mbështetjes së Konfederatës së Zvicrës për Republikën e Shqipërinë.

Qëllimi kryesor i projektit është rritja e kontributit të KLSH-së për të forcuar llogaridhënien qeveritare në përdorimin e fondeve publike përmes auditimeve më profesionale dhe gjithëpërfshirëse të prokurimeve publike, koncesioneve dhe partneriteteve publike-private, duke përdorur mjete IT në kryerjen e auditimeve financiare, përputhshmërisë dhe performancës në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe praktikat e mira profesionale për sektorin publik.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të nxisë mbikëqyrjen publike dhe të rrisë cilësinë, transparencën dhe frenimin e korrupsionit në ofertat publike, koncesionet dhe partneritetet publike-private (PPP). Ky projekt do të bëjë të mundur krijimin e eksperiencave të reja dhe do të përsosë njohuritë dhe aftësitë e audituesve të KLSH-së për të mbikëqyrur fushën e koncesioneve dhe kontratave të partneritetit publik-privat duke sjellë dhe plotësimin e një kornize të përshtatshme për të siguruar që këto lloj kontratash ofrojnë vlerë të shtuar dhe minimizojnë risqet në kushtet e financimit publik. I gjithë ky proces nuk mund të bëhet pa garantuar që audituesit kanë aftësitë e duhura teknike lidhur me përdorimin e mjeteve të teknologjisë së informacionit në auditim.

Projekti do të mundësojë auditime më cilësore dhe do të japë rekomandime me vlerë të shtuar në mirëmenaxhimin e kontratave të PPP-ve, duke përmirësuar dhe kuadrin ligjor të realizimit të tenderave publike përkatës dhe të lidhjes dhe zbatimit të kontratave koncesionare. Ky projekt dy vjeçar do të ndihmojë dukshëm në drejtim të auditimit më profesional të fondeve publike në fushën e koncesioneve dhe PPP-ve në Shqipëri.

ANALIZA E OBJEKTIVAVE INSTITUCIONALE TË KLSH-SË, REFERUAR BUXHETIT TË ORIENTUAR NË REZULTATE PER PERIUDHEN E VITIT 2023

KLSH përgjatë vitit 2023 vijoi veprimtarinë menaxheriale institucionale suportuar nga një qeverisje e brendshme efektive dhe mirëfunksionimi të sistemeve të kontrollit të brendshëm duke siguruar përputhshmërinë me standardet e kontrollit të brendshëm me qëllim sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe përmbushjen e objektivave Strategjike në nivelin e pritshmërive të synuara drejt konsolidimit të reformave të ndërmarra, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit, ISSAI, me rekomandimet e Progres Raporteve të BE, me detyrimet kushtetuese dhe me pritshmërinë e Kuvendit, publikut dhe të gjitha palëve të interesit.

I. MISIONI, VIZIONI DHE OBJEKTIVAT E KLSH-së

Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar. Ai i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve.

Misioni

Informimi i publikut dhe i Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me përdorimin e burimeve me ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet nga pushteti qendror dhe lokal dhe nga njësi të tjera publike, si dhe nxitja e përgjegjshmërisë në të gjithë sektorin publik, në përputhje me praktikën me të mira të BE dhe me standardet ndërkombëtare të INTOSAI, duke kontribuar për qeverisjen e mirë, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.

Vizioni

KLSH synon të jetë një institucion profesional i besueshëm që i kontribuon shtimit dhe kursimit të vlerës së parave publike, duke dhënë siguri mbi llogaritë financiare të përdoruesve të tyre dhe duke ndihmuar në përmirësimin e menaxhimit të Qeverisë e të enteve të tjera publike nëpërmjet auditimit, duke fituar në këtë mënyrë besim të plotë tek qytetarët shqiptarë dhe të audituarit.

Objektivat:


Tre qëllimet strategjike që do të udhëheqin punën e KLSH-së në pesë vitet e ardhshme janë:

1. Rritja dhe përmirësimi i rolit të KLSH si mbështetës i Kuvendit për llogaridhënie efektive dhe shqyrtim të kujdesshëm e të thelluar të enteve përdoruese të fondeve publike.
2. Rritja e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë, nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve.
3. Optimizimi i kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese.

MBI REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE TË MENAXHIMIT INSTITUCIONAL.

Mbi realizimin e planit të auditimeve gjatë periudhës Janar-Prill 2022.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën janar – prill 2023, ka vijuar punën audituese në zbatim të planit të miratuar me vendimin nr. 234 datë 16.12.2022 të Kryetarit të KLSH-së, duke kryer dhe evaduar 16 misione auditimi, në vlerësim të përputhshmërisë, rregullshmërisë financiare, performancës dhe ndjekjes së statusit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në periudha të mëparshme. Detajuar sipas llojit të auditimit, aktiviteti auditues paraqitet në tabelën në vijim:



Institucionet ku janë kryer auditimet

Në periudhën janar – prill 2023, auditimet e kryera kanë përfshirë vlerësimin e aktivitetit në 55 subjekte duke përfshirë nivele të ndryshme të qeverisjes si: institucione qendrore, ministri dhe agjenci (përfshirë drejtori qendrore dhe rajonale në varësi të tyre), njësi të vetëqeverisjes vendore, drejtori të përgjithshme të administrimit fiskal, si dhe shoqëri aksionare me kapital shtetëror në të cilën shteti ka mbi 50% të aksioneve, apo projekte me financim të huaj.

Opinionet/mesazhet/konkluzionet sipas llojit të auditimit

Bazuar në planin vjetor, Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën janar – prill 2023, ka përfunduar kryerjen e 16 auditimeve, duke dhënë:

- 15 opinione për 12 auditime, nga të cilat: 3 opinione financiare, 6 opinione përputhshmërie dhe 6 opinione për 3 auditimet e kombinuara;
- 3 mesazhe auditimi për 3 auditime performance;
- 1 konkluzion për 1 auditim tematik IT.

Përmirësime ligjore & Masa organizative

Gjatë periudhës janar – prill 2023, për 16 auditimet e përfunduara, KLSH ka adresuar rekomandime për 280 masa organizative dhe 5 përmirësime ligjore, në institucionet publike të audituara, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e situatës,

Rekomandimet për përmirësime ligjore janë dhënë në:

fushën e drejtësisë për çështje që lidhen me: kriteret e pranimit në Policinë e Burgjeve; dhe me ndihmën juridike të ofruar nga shteti mbi ofrimin e kushteve dhe garantimin e të drejtave për të paraburgosurit; si dhe

në fushën e mbrojtjes së sipërmarrjes për rishikimin dhe ridimensionimin e rolit të Ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes në drejtim forcimit të promovimit, zhvillimit dhe koordinimit të politikave shtetërore në mbështetje të start-upeve dhe ekosistemit të tyre.

Gjetje me efekte financiare negative në buxhetin e shtetit

Gjatë periudhës janar-prill 2023, janë dhënë 60 rekomandime mbi gjetje me efekte negative në buxhetin e shtetit, për total vlerën 2,311,028 mijë lekë, nga të cilat: dëmi ekonomik vlerësuar 87,583 mijë lekë, dhe menaxhimi jo efektiv i fondeve në vlerën 2,223,445 mijë lekë.

Rreth 2% e efekteve financiare me pasojë dëm ekonomik* në buxhetin e shtetit, është konstatuar në fushën e të ardhurave; ndërsa pjesa më përfaqësuese, rreth 98% është konstatuar në fushën e shpenzimeve ku:

- vlera prej 47,987 mijë lekë e konstatuar në subjektin Ujësjellës Kanalizime Tiranë SH.A për shkak të mos parashikimit nga palët, në kontratën e qirasë të detyrimit për sigurimin e pronës në rastet e rreziqeve të shkaktuara nga zjarri; dhe

• vlera prej 38,051 mijë lekë e konstatuar përgjatë zbatimit të punimeve (si psh diferenca në volumin e punimeve, zëra të paverifikueshëm punimesh, etj) në 5 subjekte.

Sa i takon menaxhimit jo efektiv të fondeve**, në shumën totale prej 2,223,445 mijë lekë, rreth 66% e vlerës është konstatuar në fushën e të ardhurave, ndërsa rreth 34% në fushën e shpenzimeve, ku:

- rreth 99% e vlerës në fushën e shpenzimeve, përbëhet nga shkeljet në "procedurat e prokurimit" dhe "zbatimin e punimeve"; ndërsa rreth 90% e vlerës në fushën e të
- adhurave përbëhet nga të ardhurat e munguara që administrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, si pasojë e krijimit të debitorëve për moslikuidime të tarifave dhe taksave vendore (më së shumti në Bashkitë: Kamëz (631,061 mijë lekë), Belsh (108,398 mijë lekë), Lezhë (402,195 mijë lekë) dhe Vau i Dejës (195,912 mijë lekë).

KLSH, në përfundim të auditimeve të kryera përgjatë periudhës janar – prill 2023, ka zbuluar parregullsi dhe shkelje financiare me pasojë dëm ekonomik, në të ardhura dhe shpenzime në shumën totale prej 87,583 mijë lekë, nga e cila ka rekomanduar për shpërblim dëmi të njëjtën shumë.

Mbi trajnimet e realizuara gjatë periudhës Janar-Prill 2023.

Gjatë periudhës janar-prill 2023, u realizuan 31 tema trajnimesh, nga të cilat 14 nga ASPA dhe 17 nga KLSH & partnerë ndërkombëtarë si EUROSAT, IDI, SAI i Suedisë dhe ai i Norvegjisë. U trajnuan gjithsej 127 auditues, duke realizuar në total 529 ditë-njerëz trajnime, ose realizuar mesatarisht rreth 4.2 ditë trajnimi/auditues.

Këtë vit, ndryshe nga periudha që lam pas, u rikthyen trajnimet në sallë, në shërbim kjo të rritjes së ndërveprimit mes pjesëmarrësve, ku nga 283 ditë-njerëz trajnime të organizuara nga KLSH, vetëm 14 (ose 5%) janë realizuar on line.

Ndër temat kryesore të trajtuara gjatë këtij 3 mujori, nga SAI-e partnere dhe/ose komuniteti EUROSAT përmendim:

- “Qasja praktike DEA SG2”, organizuar nga EUROSAT;
- “IDI-SPMR Round 2, implementimi dhe raportimi”, organizuar nga IDI;
- “Ndikimi i transportit rrugor në cilësinë e ajrit”, organizuar nga SAI i Norvegjisë;
- “Konceptet e auditimit të performances”, organizuar nga SAI i Suedisë.

Një informacion më i detajuar në lidhje me veprimtarinë e kryer për periudhën Janar-Prill 2023, jepet në Buletinin Statistikor për periudhën Janar-Prill 2023, të publikuar në faqen web të KLSH-së.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM



Viti 2023
Periudha: Janar-Prill

2023

VIII



Përgjegjës Sektori Finance	Alketa Kalleshi	Sekretari i Përgjithshëm	Valbona Gaxha
	Firma		Firma
	Data 25/05/2023		Data 25/05/2023

ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"

Viti 2023
Periudha: Janar-Prill

Programi	Programi Veprimtari Audituese e KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit	Kodi i Grupit	Kodi i Programit
			1024001	01120

Në 000/lekë

Artikulli	Programi	Fakti Paraardhes Viti 2022	PBA Viti 2023	Plan Fillestar Viti-2023	Plan Rishikuar Viti-2023	Plan Progrosiv Janar-Prill	Fakti Janar-Prill 2022	Diferenca
600	Paga	290,957	319,000	351,300	351,300	115,098	104,031	-11,067
601	Sigurime Shoqërore	47,126	42,000	46,800	46,800	16,902	16,902	0
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	72,158	88,000	87,850	87,850	30,650	18,253	-12,397
605	Transferta Korente të Huaja			150	150	150	116	-34
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ			1,600	1,600	1,600		-1,600
Nen -Totali	Shpenzime Korrente	410,241	449,000	487,700	487,700	164,400	139,302	-25,098
230	Kapitale të Trupëzuara	4,291		5,000	5,000	5,000	1,090	-3,910
231	Kapitale të Trupëzuara	13,032	20,000	15,000	15,000	15,000	25	-14,975
232	Transferta Kapitale							0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	17,323	20,000	20,000	20,000	20,000	1,115	-18,885
230	Kapitale të Trupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara		3,000	3,000	3,000	3,000	5,040	2,040
232	Transferta Kapitale							0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	3,000	3,000	3,000	3,000	5,040	2,040
Totali	Shpenzime Kapitale	17,323	23,000	23,000	23,000	23,000	6,155	-16,845
	Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti						0	
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		427,564	472,000	510,700	510,700	187,400	145,457	-41,943

Pergjegjes Sektori Finance	Alketa Kalleshi	Sekretari i Përgjithshëm	Valbona Gaxha
	Firma		Firma
	Data 25/05/2023		Data 25/05/2023

ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treguesve te performances/produteve te programit"

Viti 2023

Perioduha; Janar-Prill

Emri i Grupit	Kodri i Grupit	1024001
Programi	Programi	01120
	Programi Veprimtari Auditues e KLSH	
	Kontrolli i Larte i Shtetit	

	nc 000/leke				I			II		III		IV	Luhatjet ne Kostom per Njesi			
Kodi	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Njësia matese	Sasia Faktike Viti 2022	Shpenzimet (Viti2022)	Kosto per Njesi (Viti 2022)	Sasia (sipas planit Viti 2023)	Shpenzimet (sipas planit te vitit 2023)	Kosto per Njesi (sipas planit te vitit korent)	Sasia (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Kosto per Njesi Faktike (ne fund te vitit korent)	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III	
A	Auditime te kryera	numer	177	410,241	2,318	162	486,100	3,001	162	486,100	3,001	16	139,302	6,389	5,706	5,706
B	Blerje paisje kompjuterike	numer		2,580			13,400			13,400			25	0	0	0
C	Blerje paisje zyre	numer		668			1,600			1,600						
D	Blerie Automjete	numer		8,580			0			0						
E	Kosto Lokale	numer		4,291			5,000			5,000			1,090			
F	Rikonstruksion Godine	numer		1,203			0			0						

Përgjegjës Sektori Finance	Alketa Kallushi Firma Data 25/05/2023	Sekretari i Përgjithshëm Firma Data 25/05/2023	Mëlbore Gaxha Firma Data 25/05/2023
----------------------------------	---	--	---




ANEKSI nr.4 "Raporti i realizimit te objektivave te politikës se programit"

Viti 2023
 Periudha: Janar-Prill

Kodi i Programit	1024001	Emertimi i programit:	Veprimtari Auditueses e Kontrollit te Larte te Shtetit						
Qellimi 1	" Ushtrimi i veprimtarise audituese ne nje linje me standartet nderkombetare te auditimit mbi perdorimin me efektivitet, eficence dhe ekonomicitet te fondeve publike ne funksion te rritjes se pergjeshmerise se menaxhimit te financave e pasurise publike duke sjelle vlere te situar per shoqerine dhe ndryshim ne jeten e qytetareve"								
			**Treguesit e performancës/Produktet:						
	Objektivat e politikës	Kodi i Treguesit te Performances/Produkti	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produkti	Niveli faktik i vitit 2022	Niveli i planifikuar ne vitin 2023	Niveli i rishikuar ne vitin 2023	Niveli faktik ne fund te periudhes	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
Objektivi 1.	"Mbulimi me auditime financiare perputhshmerie dhe performance i njesive te sektorit publik nepermjet konsolidimit te auditimeve te perputhshmerise rritjes se auditimeve financiare dhe te performances ne nje linje me Standartet Nderkombetare te Auditimit ISSAI"	A	Auditime te kryera	177	162	162	16	10%	
Objektivi 1.1	Ofrimi i kushteve cilesore te punës për zhvillimin e aktivitetit auditues të KLSH-së nëpërmjet investimit për ngritjen e godinës dhe përmirësimit i infrastrukturës akomoduese me paisje dhe orëndi të nevojshme, në funksion të ushtrimit normal të veprimtarisë institucionale.								
		B	Blerje paisje kompjuterike						
		C	Blerje paisje zyre						

Pergjegjesi Sektori Finance	Alketa Kalleshi	Sekretari i Pergjithshem	Valbona Gaxha
	Firma		Firma
	Data 25/05/2023		Data 25/05/2023



ANEKSI nr.5 "Projektet e investimeve me financim te brendshem dhe me financim te huaj"

Viti 2023
Periudha: Janar-Prill

Projektet me financim te brendshem (ne 000/leke)

Emri i Grupit		Kontrolli i Larte i Shtetit					Kodi i Grupit		1024001	
Programi		Programi Veprimtari Audituese e KLSH					Kodi i Programit		01120	
Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë e Projektit.	Viti i fillimit te Projektit	Viti i përfundimit te Projektit	Buxheti 2023 Kontraktuar.	Plani i buxhetit viti 2022	Realizimi Progressiv nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Realizimpër periudhën e raportimit	Realizimi Progressiv nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	Komente
M240009	Blerje pajisje kompjuterike	13,400	2023	2023			25	25	25	
M240010	Blerje pajisje zyre	1,600	2023	2023				0	0	
19AA402	Kosto Lokale	5,000	2023	2023			1,090	1,090	1,090	
		20,000			0	0	1,115	1,115	1,115	0

Projektet me financim te huaj (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Grant	Vlera e plotë e Projektit.	Viti i fillimit te Projektit	Viti i përfundimit te Projektit	Buxheti I Kontraktuar	Plani i buxhetit viti 2023.	Realizimi për periudhën e raportimit	Realizimi Progressiv nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	Realizimi Progressiv nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale
19AA401	Foreimi i rolit të Auditimit të Jashtëm në mbikqyrjen e partneritetit publik-privat në Shqipëri	Grant/	24519	2023	2024	0	3000	5400	0	0

Pergjegjesi Sektori Finance	Emri	Alketa Kalleshi	Sekretari i Pergjithshem	Emri	Valbona Gaxha
	Firma	<i>[Signature]</i>		Firma	<i>[Signature]</i>
	Data	25/05/2023		Data	25/05/2023

